



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 15 janar 2013  
Nr. ref.: RK342/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI75/12**

Parashtruesi

**Faton Sefa**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjyimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është z. Faton Sefa, me banim në Gjakovë, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 106/2012, të 2 majit 2012, i cili iu dorëzua parashtruesit më 20 qershor 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012, me ç'rast supozohet se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtimit të Profesionit], me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut (në tekstin e mëtejme: ECHR), përkatësisht me nenin 6 (E Drejta për Gjykim të Drejtë) dhe me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 13 gusht 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 gusht 2012, parashtruesi dorëzoi autorizimin e avokatit.
7. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI75/12, caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI75/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 12 tetor 2012, Gjykata kërkoi sqarime nga Gjykata Supreme përkitazi me Aktgjykimin Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012. Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të kërkesës, ka vërejtur se kopja e Aktgjykimit Rev. nr. 106/2010 përmbante mospërputhshmëri sa i përket datës së seancës kryesore, që ishte më 09.04.2012, dhe datës së publikimit të Aktgjykimit që përmendet në fund të atij Aktgjykimi, e që ishte më 09.02.2012. Kjo nënkuptonte se Aktgjykimi ishte publikuar 2 muaj para datës së seancës kryesore.
9. Më 25 tetor 2012, Gjykata Supreme iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese, duke ofruar një Vendim për të korrigjuar Aktgjykimin Rev. nr. 106/2010, me ç'rast thuhet se datë korrekte duhet të jetë 2 maji 2012.
10. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 18 gusht 2006, kompania "Hidrosistemi Radoniqi" në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Kompania), ndërpreu kontratën e punës me parashtruesin, sepse pretendohet se parashtruesi nuk kishte përmbushur detyrimet e tij ndaj punës në bazë të kontratës së punës.
12. Më 24 gusht 2006, parashtruesi parashtrroi një kërkesë për shqyrtim në Bordin e kompanisë "Hidrosistemi Radoniqi".
13. Edhe pse ky vendim nuk është në kërkesë ose në shkresat e lëndës, parashtruesi pretendon se, më 25 gusht 2006, Komisioni disiplinor ka mbështetur vendimin e Kompanisë, të datës 18 gusht 2006, për të ndërprerë kontratën e punës me parashtruesin.
14. Më 30 gusht 2006, parashtruesi u ankua te Menaxheri i përgjithshëm i Kompanisë, kundër vendimit të Komisionit disiplinor.
15. Edhe pse ky vendim nuk gjendet në kërkesë ose në shkresat e lëndës, parashtruesi pretendon se, më 21 shtator 2006, Menaxheri i përgjithshëm gjeti si të pabazuar ankesën e parashtruesit kundër Komisionit disiplinor.
16. As kontrata e punës së parashtruesit, e as procesverbali i Komisionit disiplinor, nuk gjenden në kërkesë apo në shkresat e lëndës.
17. Nuk është e qartë se a ishte ftuar parashtruesi të marrë pjesë në procedurat e Komisionit disiplinor.
18. Më 8 janar 2009, Gjykata Komunale e Gjakovës (Aktgjykimi C. nr. 172/08) anuloi Vendimin e Komisionit disiplinor, të 25 gushtit 2006, dhe Vendimin e Menaxherit të përgjithshëm, të datës 21 shtator 2006. Më tej, Gjykata Komunale urdhëroi Kompaninë që të kthejë parashtruesin në pozitën e tij të punës dhe, nëse ky kthim nuk mund të bëhet për arsye objektive, atëherë parashtruesi duhet të "... sistemohet në vendin dhe detyrat e punës në pajtim me përgatitjen profesionale dhe aftësinë e arritur në punë". Gjykata Komunale vlerësoi se "arsyet për ndërprerjen kushtëzohen në Kushtet Standarde të bashkëngjitura të punësimit dhe në Ligjin Themelor të Punës të Kosovës". Për më tepër, Gjykata Komunale vlerësoi se "shqyrtimi ishte kryer pa ftesën dhe pa prezencën e punëtorit, pra ka qenë e pamundur të paraqet mbrojtjen e tij". Kompania ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.
19. Më 9 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi Ac. nr. 176/09) ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 8 janarit 2009, dhe ankesa e parashtruesit u hodh poshtë si e pabazuar. Gjykata e Qarkut në Pejë vlerësoi se "[...] e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar [...]", sepse ndërprerja e kontratës së punës është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 11.2 dhe nenit 11.4 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 në Ligjin Themelor të Punës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës 2001/27). Për më tepër, Gjykata e Qarkut po ashtu vlerësoi se masat disiplinore i janë shqiptuar parashtruesit dhe, pasi që parashtruesi vazhdoi me shkelje të tjera të detyrave të punës, Kompania, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, informoi parashtruesin me shkrim dhe ka pasur një takim për ndërprerjen e kontratës së punës dhe i janë shpjeguar arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Parashtruesi pastaj paraqiti një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

20. Më 2 maj 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 106/2010) hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për revizion. Gjykata Supreme vlerësoi se “[...] marrëdhënia e punësimit të paditësit është ndërprerë në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligjin në fuqi, andaj çdo pretendim në revizion mbi këtë bazë është i papranueshëm”.

### **Pretendimet e parashtruesit**

21. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe i Gjykatës Supreme është marrë duke shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, sepse të dyja – edhe Gjykata e Qarkut në Pejë e edhe Gjykata Supreme – supozohet të kenë injoruar shkeljet procedurale gjatë procedurës disiplinore.
22. Më tutje, parashtruesi pretendon se ndërprerja e kontratës së punës së parashtruesit ishte në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, sepse ai asnjëherë nuk kishte pasur një takim me Kompaninë dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës asnjëherë nuk ka specifikuar se cilat dispozita juridike ishin shkelur nga ai.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

23. Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton: “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.
25. Më tej, Gjykata i referohet gjithashtu edhe rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës, që përcakton: “Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar”.
26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkritazi me vendimet e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis. Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], ro. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).
27. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991*).
28. Në fakt, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga parashtruesi, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se ai ishte i ftuar ose jo për të marrë pjesë në procedurat disiplinore dhe nëse Gjykata Supreme e injoroi këtë fakt apo jo. Mospajtimi i thjeshtë me Aktgjykimin, i shoqëruar me renditjen e disa dispozitave kushtetuese, nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një rast për shkelje kushtetuese.

29. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtuesi nuk ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës, andaj kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin nr. KI13/09, Sevdail Avdyli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 533/2006, i 11 shtatorit 2006, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, A. nr. 533/2006, i 2 dhjetorit 2006, 17 qershor 2010*).

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1.c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues

  
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



  
Prof. dr. Enver Hasani